



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 17/2 Prot.

Tiranë, më 23 / 01 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 12 , Datë 23 / 01 / 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 03, datë 08.01.2019, të paraqitur nga shtetasi G.D kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën pretendohet diskriminim, por pa përcaktuar një shkak të mbrojtur. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga G.D, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Prej shumë vitesh ka qenë punonjës i administratës tatimore me statusin e nëpunësit civil dhe me Vendimin nr.1071, datë 23.06.2014 i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.6595, datë 17.11.2014 vendosi shfuqizimin e vendimit që e largonte nga shërbimi civil, detyrimin për kthimin në vendin e punës dhe detyrimin e pagesës deri në rikthimin në punë. Gjykata e Apelit Administrativ me Vendimin nr.17.05.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr, 6595, datë 17.11.2014. Vendimin e gjykatës e ka dërguar për ekzekutim tek Përmbartuesi Gjyqësor, por deri më sot nuk është bërë i mundur rikthimi në punë. Në lidhje me pagesën, administrata tatimore është shprehur, se në grafikun për vitin 2018 do të paguante dy këste, në muajt Qershor dhe Nëntor. Pagesa e muajit Qershor është kryer konform planifikimit ndërsa pagesa e muajit Nëntor nuk është kryer”.*

Ankuesi shpjegon se administrata tatimore me veprimet e saj e ka diskriminuar, përbuzur dhe e ka trajtuar jo si të barabartë me të tjerët për argumentet e mëposhtme:

- Është përcaktuar një grafik dhe nuk është zbatuar nga vetë institucioni që e ka hartuar atë.
- Pagesat nuk janë bërë sipas grafikut, por është shkelur ai duke mos zbatuar radhën dhe afatet.

- Janë paguar persona jashtë grafikut, pra persona që nuk ishin planifikuar për vitin 2018.
- Në mënyrë të qëllim të qëllim nga administrata tatimore nuk i është vënë në dispozicion grafiku i plotë por vetëm ai që i takon përmbaruesit që ndjek çështjen e tij, duke fshehur grafikun për emrat e tjerë të planifikuar për vitin 2018.
- Janë paguar persona që kanë qenë pas tij në radhë, duke injoruar emrin e tij dhe duke nëpërkëmbur të drejtat e tija.
- Janë paguar persona që nuk kanë bërë kërkesë për ekzekutim vendimi e jo më që të jenë planifikuar në grafik.
- Janë paguar persona të cilët duhet të ishin planifikuar për vitin 2019 në bazë të kohës kur kanë paraqitur kërkesën.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 17.01.2019, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime lidhur me shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe shpjegime të trajtimit të pabarabartë në raport me kreditorët e tjerë për shkakun e pretenduar.
- Me e-mailin datë 21.01.2019, subjekti ankues ka informuar se: *“Në lidhje me shkakun e diskriminimit nuk mund ta thotë me saktësi por mendon se ka të bëjë me marrëdhëniet e punës, për shkak se konsiderohet si një njeri i urtë dhe nuk sjell shqetësime, për shkak të trajtimit institucional që i bën çështjes”*.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me*

*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Termi “çdo shkak tjetër” nuk përbën shkak më vehte. Ankuesi duhet të identifikojë një cilësi apo karakteristikë personale për të cilën pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me problematikën që ka me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të pretenduar dhe për të provuar se mos pagesa e këstit të dytë të vitit 2018 është bërë për shkak të cilësive të veçanta që ankuesi ka.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se, shtetasi G.D mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por në bazë të rrethanave të shpjeguara nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “...ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetimi”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit G.D, për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**